

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **320-26-3254-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Sigurim fizik të QNR-së dhe objekteve të KQZ-së -retender**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	International Security AAH SH.P.K.
NUI	811371434
Adresa	RR. REXHEP BISLIMI , FERIZAJ , KOSOVO
Vendi	Ferizaj
Kodi postar	70000
Numri Telefonit	044/500-662
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Kumrie Syla
Adresa elektronike	ahh.international@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	04.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sigurim fizik të QNR-së dhe objekteve të KQZ-së -retender

Lënda: Shërbime

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur

FPP fjalori kryesor: 93000000-8 Shërbime të ndryshme

Vlera e parashikuar: 70,000.00€ (e mesme)

B05 Njoftimi për Kontratë

Data: 07.05.2026 13:35

Afati për dorëzimin e tenderëve:

Data: 14.04.2026 – Ora: 13:30

Hapja e ofertave – Procesverbali i hapjes:

Data: 19.05.2026 14:00

Njoftimi mbi vendimin e AK-së:

Data: 18.06.2026 15:06

Kriteri për dhënien e kontratës:

Çmimi më i ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Konform Nenit 108/A të LPP-së me datën 22.06.2026 në afatin e lejuar ligjor kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim.

Autoriteti Kontraktues përmes vendimit të saj ka Refuzuar si të pabazuar kërkesën tonë për rishqyrtim 29.06.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Legjislacioni primar -

1. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 1 - Qëllimi,

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti,

Neni 7 - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi,

Neni 51 - Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes,

Neni 52 - Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës,

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,

Neni 69 - Aftësitë teknike dhe/ose profesionale.

- Legjislacioni sekondar –

2. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 17 - Dosja e tenderit,

Neni 25 - Kriteret e përzgjedhjes,

Neni 27 - Kriteret e dhënies së kontratës,

Neni 38 - Sqarimi i Tenderëve,

Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,

Neni 45 - Procedura e Hapur.

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në afatin e lejuar ligjor, në mbështetje të Nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Nenit 4.1.26 të LPP-së, Operatori Ekonomik: International Security AAH sh.p.k., në cilësinë e palës së interesit, paraqet këtë Ankesë lidhur me procedurën e prokurimit:

Titulli: Sigurim fizik të QNR-së dhe objekteve të KQZ-së - retender
Nr. prokurimit: 320-26-3254-2-2-1

Kompania jonë ka vepruar "*strictus secundum*" dosjen e tenderit, duke përfshirë në analizë vetëm ato elemente për të cilat është dhënë kërkesa eksplicite.

I. PËRMBUSHJA E KËRKESAVE TË DOSJES SË TENDERIT

Autoriteti Kontraktues në vendimin e tij pretendon se OE International Security AAH SH.P.K. nuk ka dorëzuar "Kartelat e Identifikimit të punëtorëve të Sigurimit Fizik" dhe për këtë arsye e ka konsideruar ofertën tonë si të papërgjegjshme.

Ky konstatim është i pabazuar për faktin se në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë nuk ka ekzistuar asnjë kërkesë e tillë.

Kërkesa e vetme e përcaktuar nga AK ka qenë:

"4.Dëshmi për licencimin e të gjithë punëtorëve të kompanisë (kopje të licencave të rojeve të sigurimit)" dhe "4.Licencat e punëtorëve të kompanisë."

Në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit **nuk kërkohet:**

- Kartela identifikimi e rojeve të sigurimit;
- Kartela valide të lëshuara nga MPB;
- Dëshmi shtesë përveç licencave;
- Kushti që licencat duhet të jenë valide në momentin e ofertimit.

Prandaj, AK nuk mund të krijojë kërkesa të reja gjatë fazës së vlerësimit të ofertave dhe të eliminojë operatorët ekonomikë mbi bazën e dokumenteve që nuk janë kërkuar paraprakisht në Dosjen e Tenderit.

Rrjedhimisht, ky kriter i aplikuar "*ex post*" është i paligjshëm dhe i pavlefshëm juridikisht.

Kjo është në kundërshtim me **Nenin 40.13 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik**, i cili përcakton:

"Komisioni vlerësues do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit."

II. NDRYSHIMI I KRITEREVE PAS HAPJES SË OFERTAVE

AK fillimisht ka kërkuar licencat e punëtorëve.

Pas dorëzimit të sqarimeve, AK ka ndryshuar natyrën e kërkesës duke kërkuar dokumente krejtësisht të tjera, respektivisht "Kartelat e Identifikimit të Punëtorëve të Sigurimit Fizik", të cilat nuk janë paraparë as në dosjen e tenderit e as në njoftimin për kontratë.

Një veprim i tillë përbën ndryshim të kriterëve pas hapjes së ofertave dhe bie ndesh me parimin e transparencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit sipas nenit 7 të LPP-së.

AK është i obliguar të vlerësojë ofertat vetëm mbi bazën e kërkesave të publikuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit dhe jo mbi baza të reja të krijuara gjatë procesit të vlerësimit.

Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejtë të **Nenit 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, i cili përcakton se:

"Autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriterë ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve."

III. SQARIMI ZYRTAR I MPB-SË

Përtej dokumenteve të kërkuara në Dosjen e Tenderit, OE International Security AAH SH.P.K. ka dorëzuar edhe sqarimin zyrtar lidhur me ndryshimet ligjore të bëra me Ligjin Nr. 08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë.

Nga përgjigja dhe sqarimi zyrtar i organit kompetent rezulton se:

- Licencat e mëparshme të punëtorëve nuk lëshohen më;
- Sistemi i licencimit individual është ndryshuar;
- Punëtorët certifikohen sipas legjislacionit të ri;
- Certifikatat e lëshuara nga MPB janë dokumenti përkatës sipas legjislacionit aktual.

Madje, përmes sqarimeve të kërkuara nga AK, ne kemi dorëzuar edhe certifikatat përkatëse, ndonëse ato nuk kanë qenë të kërkuara në Dosjen e Tenderit. Prandaj, eliminiimi ynë për mosdorëzimin e një dokumenti që nuk është kërkuar fare në Dosjen e Tenderit dhe i cili nuk parashihet si kriter kualifikues, është i pabazuar dhe i kundërligjshëm.

Gjithashtu, sipas Nenit 40.12 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

"Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit."

IV. MOSPËRPUTHJA E KËRKESAVE TË AUTORITETIT KONTRAKTUES ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Përveç faktit se OE International Security AAH SH.P.K. ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka dështuar të harmonizojë kërkesat e tenderit me legjislacionin aktual në fuqi për Shërbimet Private të Sigurisë.

Autoriteti Kontraktues, para publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, ka pasur obligim që të verifikojë bazën ligjore mbi të cilën mbështeten kërkesat kualifikuese dhe tekniko-profesionale, veçanërisht kur bëhet fjalë për një sektor të rregulluar me ligj të veçantë siç është sektori i Shërbimeve Private të Sigurisë.

Në rastin konkret, AK ka vazhduar të kërkojë "licenca të rojeve të sigurimit", ndonëse sipas Ligjit Nr. 08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë dhe praktikës së zbatimit nga Ministria e Punëve të Brendshme, licencat individuale të punëtorëve nuk lëshohen më në formën e mëparshme. Për këtë fakt, AK është dashur të informohet dhe të konsultohet me institucionin kompetent para publikimit të kërkesave të tenderit.

Nëse AK ka konsideruar se për verifikimin e kualifikimit profesional të punëtorëve nevojiten certifikata, kartela identifikimi apo ndonjë dokument tjetër, atëherë ka qenë obligim i tij që këto dokumente t'i specifikojë qartë dhe pa ekuivoke në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të kenë mundësi të përgatisin ofertat e tyre sipas të njëjtave kërkesa.

Nuk është e lejueshme që pas dorëzimit të ofertave dhe gjatë fazës së vlerësimit të krijohen kërkesa të reja apo të ndryshohet kuptimi i kërkesave ekzistuese duke kërkuar dokumente të cilat nuk kanë qenë pjesë e Dosjes së Tenderit.

Pavarësisht kësaj, OE International Security AAH SH.P.K. ka përmbushur plotësisht kërkesën e vendosur nga AK duke dorëzuar licencat e kërkuara në ofertë. Madje, përtej asaj që është kërkuar në Dosjen e Tenderit, gjatë fazës së sqarimeve kemi dorëzuar edhe përgjigjen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila sqaron se licencat individuale nuk lëshohen më sipas legjislacionit aktual dhe se certifikatat përkatëse përbëjnë dëshminë valide të aftësisimit profesional të punëtorëve.

Po ashtu, në përgjigje të kërkesës për sqarime, kemi dorëzuar edhe certifikatat e punëtorëve, ndonëse ato nuk kanë qenë të kërkuara fillimisht në Dosjen e Tenderit.

Prandaj, eliminimi i OE International Security AAH SH.P.K. për mungesë të

dokumenteve që nuk kanë qenë të kërkuara në Dosjen e Tenderit përbën shkelje të parimit të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, si dhe cenon sigurinë juridike të pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të penalizojë operatorët ekonomikë për pasaktësitë apo mosazhurnimin e kërkesave të veta tenderuese me legjislacionin aktual në fuqi, veçanërisht kur operatori ekonomik ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara dhe ka ofruar edhe dokumentacion shtesë zyrtar nga institucioni kompetent për të sqaruar situatën juridike.

V. SHKELJA E NENIT 7 TË LPP-SË

OE International Security AAH SH.P.K. ka kërkuar qasje në dokumentet publike të aktivitetit të prokurimit për të verifikuar ligjshmërinë e procesit të vlerësimit. Megjithatë, AK ka refuzuar dhënien e qasjes duke pretenduar se dokumentet janë "sekrete afariste".

Një veprim i tillë bie ndesh me:

- Nenin 7 të LPP-së;
- Parimin e transparencës;
- Të drejtën e operatorëve ekonomikë për qasje në dokumentacionin publik të procedurës së prokurimit.

Dokumentet që përdoren për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të tenderit nuk mund të klasifikohen automatikisht si sekrete afariste pa një arsyetim të bazuar ligjërisht.

Moslejimi i qasjes në dokumentet relevante ka pamundësuar ushtrimin efektiv të të drejtave tona ligjore dhe ngrit dyshime serioze lidhur me transparencën e procesit të vlerësimit.

Gjithashtu, sipas **Nenit 7.6.3 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:**

"Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët."

Me çrast Autoriteti Kontraktues, qasjen është dashur ta lejoj ashtu siç thuhet në dispozitën e lartëcekur, menjëherë, e jo të mos e lejoj për palët e interesit.

Në mungesë të qasjes në dokumentet publike, ne nuk kemi arritur të analizojmë dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, andaj ky veprim i AK-së është i qëllimshëm dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë dëmton kompaninë tonë dhe në anën tjetër favorizon operatorin ekonomik fitues sipas AK-së.

Mosveprimi i AK-së në këtë rast përbën trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomik dhe vlerësim jo të njëjtë të dokumentacionit ofertues, në kundërshtim me parimet themelore të LPP-së për transparencë, proporcionalitet dhe trajtim të barabartë.

Nga të gjitha këto rrethana rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar standard të njëjtë të vlerësimit për të gjithë Operatorët Ekonomik, duke vepruar në kundërshtim me parimet themelore të LPP-së për:

- trajtim të barabartë;
- proporcionalitet;
- konkurrencë të drejtë;
- dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në fakt, nga të gjitha ofertat e paraqitura, vetëm oferta jonë rezulton të jetë në përputhje të plotë si në aspektin administrativ, teknik dhe financiar me kërkesat e Dosjes së Tenderit, ndërsa operatorët e tjerë kanë mangësi substanciale që AK i ka anashkaluar pa asnjë arsyetim objektiv.

VI. KONKLUZION

Nga sa më sipër rezulton qartë se:

- të gjitha arsyet e eliminimit janë formale, të paqëndrueshme dhe të pabazuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë,
- janë aplikuar kërkesa të reja pas dorëzimit të ofertave, në kundërshtim me LPP dhe Rregulloren 001/2022 për Prokurimin Publik me qëllim të eliminimit të kompanisë sonë,
- është shkelur parimi i barazisë, transparencës, trajtimit jo të barabartë (neni 7 i LPP-së) dhe mos-përdorimit ekonomik të fondeve publike (neni 1 dhe 6 i LPP-së).

VII. KËRKESË

Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së:

1. **Të aprovojë** këtë Ankesë të bazuar;
2. **Të anulojë** vendimin mbi njoftimin e AK-së;
3. **Të kthej** procedurën në **Rivlerësim**;
4. **Të sigurojë** zbatim të drejtë dhe të njëtrajtshëm të LPP-së dhe rregullores për prokurim publik.
5. **Të detyroj AK-në ti vlerësoj** ofertat konform Nenit 59.4 të LPP-së, në vend të eliminimit të qëllimshëm për favorizim të operatorit të caktuar.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si palë e interesit në këtë aktivitet të prokurimit na janë krijuar shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat

ndërlidhen me këtë aktivitet të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në

fazën e parë dhe atë të dytë, përfaqësimeve të cilat mund të ndodhin etj.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*